

RELACIONI TEKNIK

OBJEKTI: PASTRIM KOLEKTORËVE TË UJËRAVE TË NDOTURA

Dhjetor 2022

RAPORTI TEKNIK

OBJEKTI: PASTRIM KOLEKTORËVE TË UJËRAVE TË NDOTURA

I. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT.

1. Të Përgjithshme

Hartimi i projektit të objektit “Pastrimi i kolektorëve të ujërave të ndotura”, Bashkia Durrës, është bërë nga stafi i Departamentit Teknik të SHRUK Durrës sh.a bazuar në relacionin e Drejtorisë së Grumbullimit të UN, në të cilin pasqyrohen shqetësimet e qytetarëve të zonës së Currilave dhe të disa lagjeve të qytetit për bllokimin e kolektorëve kryesorë dhe sekondar të ujërave të ndotura nga mbeturina të ndryshme, bllokimi i të cilave ka shkaktuar përmbytje të rrugëve të qytetit në ditët me rreshje të shumta atmosferike duke sjellë shqetësime jo vetëm për banorët, por edhe për qarkullimin e mjeteve.

Sistemi i Kanalizimeve të qytetit të Durrësit megjithëse i vjetër dhe i projektuar për një territor dhe popullsi shumë më të vogël se sot, vazhdon të jetë funksional pavarësisht shtesës demografike të popullatës së qytetit. Ky sistem kanalizimi i projektuar të funksionojë si sistem i përbërë, ku ujërat e ndotura të objekteve të banimit, të objekteve administrative, social-kulturore, fetare, bizneseve si dhe ujërat atmosferikë të shkarkojnë në kolektorët kryesorë dhe sekondar, ka vështirësuar në mënyrë të konsiderueshme jo vetëm punën e stacioneve të pompimit në periudha me prurje të mëdha rreshjesh atmosferike, por edhe kapacitetin e tyre përcjellës, duke shkaktuar dalje të ujërave në sipërfaqe në disa lagje të qytetit, dhe si pasojë vështirësi në jetën e banorëve si në qarkullimin e mjeteve nëpër këto zona të qytetit.

Rrjeti i kanalizimeve i cili përbëhet kryesisht nga materiale betoni dhe b/arme, tulle, tip qemer, PVC, dhe HDPE i brinjëzuar, është ndërtuar nga kolektorët kryesorë dhe sekondarë, si dhe rrjeti i jashtëm i oborrit (ku futet rrjeti i shkarkimit të UN të objekteve të banimit), të cilat administrohen nga Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës sh.a, ndërsa shkarkimet e ujërave të ndotura të të gjitha objekteve të banimit, të Enteve, të bizneseve (pra linjat terciare) janë linja që ndërtohen dhe mirëmbahen nga vetë subjektet, pasi janë pronë e tyre dhe jo e shoqërisë.

Rrjeti i kanalizimit të qytetit mbulon pothuajse rreth 50% të popullatës të zonës urbane, duke patur parasysh rritjen e numrit të popullsisë pas viteve 90-të dhe zgjerimin e territorit të qytetit të Durrësit, ku janë bërë investime për shtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe të bardha bazuar në nevojat imediate të qytetit për mbulim me rrjet kanalizimi me qëllim për të siguruar një ambient të pastër higjeno-sanitar të zonave të ndryshme të populluara.

Për sistemimin e ujërave të shiut si dhe të ujëarve të ndotura për zonat informale të qytetit, është dhënë zgjidhje inxhinierike nëpërmjet ndërtimit të një rrjeti kanalizimesh ujërash të ndotura dhe të bardha, investim ky i Qeverisë Shqiptare përfaqësuar nga AKUM në bashkëpunim me Agjencinë Franceze të Zhvillimit (AFD), i cili do të mbulojë me shërbim në sektorin e kanalizimeve zonën informale të qytetit, duke e kthyer atë në një zonë të pastër ekologjiksht për të gjithë banorët.

Sistemi i kanalizimit është një sistem i veçantë për faktin se, lëvizja e ujit bëhet me ngritje mekanike me anë të stacioneve të pompimit dhe kjo është një zgjidhje e detyruar, pasi pjerrësia e tubacioneve është e pamjaftueshme për levizjen e ujit me vetërrjedhje, dhe pastaj derdhen e tyre në kolektorët kryesorë. Stacionet e pompave janë të shpërndarë në mënyrë të tillë që të bëjnë të mundur një shfrytëzim optimal të sistemit të kanalizimeve.

Për qytetin e Durrësit, rrjeti i kanalizimeve funksionon nëpërmjet dy stacioneve të pompimit, të cilat me anë të ngritjes mekanike bëjnë që ujërat e zeza dhe të bardha të transportohen drejt Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura në fshatin ShënVlash.

Në qytetin e Durrësit kemi 5 stacione pompimi

1. Stacioni i pompave nr 7 me vendndodhje rruga "H.Kërusha" (pranë ish URT)
2. Stacioni i pompave nr 7/1 me vendndodhje rruga "H.Kërusha" (pranë ish URT)
3. Stacioni i pompave nr 8 me vendndodhje rruga "Taulantia" (pranë Portit).
4. Stacioni i pompave nr 8/1 me vendndodhje rruga "Taulantia" (pranë Portit).
5. Stacioni i pompave nr 9 me vendndodhje rruga "Vllazërimi" (zona ish Kënetës)

Ujërat e ndotura të pjesës jugore të qytetit të Durrësit mblidhen me rrjedhje të lirë në Stacionin e Pompave nr.8, ku prej andej dërgohen në Stacionin kryesor të Pompimit nr.7/1 ndërtuar në vitin 2018 me investimet e Bankës Botërore, dhe po në këtë stacion dërgohen të gjithë ujërat e pjesës veriore dhe perendimore të qytetit. UN të qytetit të mbledhura në Stacioni nr.7/1 dërgohen në Stacionin e Pompave nr.9 dhe prej andej me tubacion HDPE Ø 800 mm dërgohen në Impiantin e Trajtimit e Përpunimit, në të cilin pasi trajtohen derdhen në Kanalin e

Hapur i cili me rrjedhje të lirë për rreth 8 km i dërgon ato në Hidrovorin e Porto-Romanos, për t'u derdhur më tej në det.

2. Vendndodhja e objektit dhe gjendja ekzistuese e rrjetit të kanalizimeve

Zonat ku do të kryhet shërbimi ndodhen në pjesë periferike turistike dhe në disa lagje të qytetit dhe kryesisht:

- **Lagja nr.1, rruga "Currila", Durrës**

Kjo zonë që përfshin zonën nr.1 të faturimit ndodhet në pjesën jugore të qytetit, dhe njihet si zona turistike me një hapësirë relativisht të madhe, ku jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre një pjesë e popullsisë së qytetit.

Rruga "Currila"




Përgjatë kësaj rrugë shtrihet kolektori kryesor Ø600 mm betoni me gjatësi L= 1150 m në të cilin shkarkojnë ujërat e ndotura të objekteve të tyre një sërë subjektsh private dhe publike, numri i të cilëve është rritur për shkak të ndryshimeve demografike. Kjo zonë dikur e pashfrytëzueshme, pas viteve 90 pati një zhvillim të vrullshëm ekonomik, për shkak të shtimit demografik të popullsisë, i cili dha efektet e tij në një zhvillim urbanistik të konsiderueshëm për ekonominë e qytetit.

Blokimi i këtij kolektori është pasojë e pranisë së sasive të konsiderueshme të aluvioneve të shkaktuara nga rrëshqitja e dheut të pjesës kodrinore të qytetit me të cilën kjo rrugë kufizohet duke filluar nga hotel "Arragosta" e duke përfunduar pranë hotel "Ferrara", por edhe e depozitimeve të rërës së detit, pasi kjo zonë funksionon edhe si zonë turistike, ku ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe hotele dhe biznese të ndryshme, por edhe si zonë plazhi publik. Ky kolektor punon me rreth 60 % të kapacitetit të tij përcjellës.

- **Lagja nr.3 rruga "Spiro Puteci"**

Kjo zonë që përfshin zonën nr.3 të faturimit ndodhet në pjesën jugore të qytetit, dhe njihet jo vetëm si zona turistike, por edhe zonë social-kulturore, pasi janë të ndërtuara objekte arsimore dhe fetare që zhvillojnë aktivitetet e tyre në këtë pjesë të qytetit.

Rruga "Spiro Puteci"



Kolektori kryesor K-B' që shtrihet përgjatë kësaj rruge është ndërtuar rreth vitit 1941 është projektuar si kanal i përbërë nga dy pjesë me gjatësi $L=290$ ml, ku pjesa e parë e tij që fillon pranë Bankës Kombëtare dhe është kanal i përbërë me seksion semiovoidal me $D=0.40 \div 0.45$ m dhe me seksion vezak $D=0.50$ m, dhe pjesa e dytë K-2/B' është tubacion me diametër $\varnothing 200 \div \varnothing 300$ mm betoni, në të cilin shkarkojnë ujërat e ndotura objekte banimi, private dhe publike (social-kulturore arsimore dhe fetare).

Në këtë kolektor shkarkojnë ujërat e ndotura edhe kolektorët sekondarë të projektuar me tubacione me diametër $\varnothing 200 \div \varnothing 300$ mm betoni që shtrihen përgjatë rrugëve sekondare, si anekse të rrugës "Spiro Puteci", të cilët mbledhin shkarkimet e ujërave të ndotura të godinave të banimit, të godinave publike dhe bizneseve, dhe funksionimi i këtyre kolektorëve sekondarë varet nga pastrimi, mirëmbajtja dhe mirëfunksionimi i kolektorit kryesorë. Ky kolektor punon me reth 50 % të kapacitetit të tij përcjellës.

- **Lagja nr.4 rrugët "Egnatia" dhe "Enver Zazani"**

Kjo zonë që përfshin zonën nr.4 të faturimit ndodhet në pjesën jug-lindore të qytetit dhe njihet jo vetëm si zonë banimi, institucionale dhe arsimimi, por edhe si zonë me aktivitete të shumta biznesi, dhe që përfshin një hapësirë relativisht të madhe, ku jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së qytetit.

Rruga "Egnatia"



Rruga "Egnatia"



Në rrugën "Egnatia" ndërtimi i kolektorit kryesor S-9 gjatësi $L = 1460$ ml i përket viteve 1989-1997, i cili është i përbërë nga tubacione me diametra të ndryshëm, duke filluar me diametër $\varnothing 600$ mm betoni nga stacioni i pompave të ujërave të ndotura nr.8 deri pranë godinës së institucionit Tatim Taksa, ku vazhdon me diametër $\varnothing 1000$ mm b/arme i shtrirë përgjatë kësaj rruge, duke vazhduar përgjatë rrugës "Neki Libohova".



Ky kolektor në segmentin pranë Qendrës Tregtare “Flagship” bashkohet me kolektorin Ø1000 mm b/arme ndërtuar rreth vitit 2000 dhe që shtrihet paralel me të, me qëllimin për të lehtësuar punën përcjellëse të tij, duke ju referuar numrit të madh të godinave dhe bizneseve në këtë zonë, i cili bashkohet me S-9 në rrugën kryesore “Adria”.

Në këtë kolektor shkarkojnë ujërat e ndotura edhe kolektorët sekondarë të projektuar me tubacione me diametër Ø200 ÷ Ø600 mm betoni që shtrihen përgjatë rrugëve sekondare, si anekse të rrugës “Egnatia”, të cilët grumbullojnë shkarkimet e ujërave të ndotura të objekteve të banimit, të objekteve publike (shkolla-qendra shëndetësore), si dhe të bizneseve ku pastrimi, mirëmbajtja dhe mirëfunksionimi i këtij kolektori çon rrjedhimisht dhe në mirëfunksionimin e kolektorëve sekondarë. Ky kolektor punon me rreth 30 % të kapacitetit të përcjellës.

Rruga “Enver Zazani”

Në zonën nr.4 të faturimit ndodhet edhe rruga “Enver Zazani”, ku kolektori kryesor i ujërave të ndotura KULZ-4 me gjatësi L=280 ml i ndërtuar rreth vitit 1942, është i tipit me seksion semiovoidal me D=0.30, D=0.32 dhe D=0.35m, i cili shkarkon në rrugën “Hafiz Ali Potgorica”.





Zona ku shtrihet ky kolektor është zonë e vjetër e qytetit ku përveç godinave të banimit ka dhe objekte administrative, kopshte, çerdhe, ku ujërat e ndotura të këtyre godinave shkarkojnë në këtë kolektor. Pavarësisht pastrimit të herë pas hershëm me mjete manuale, pastrimi me automjet teknologjik me pompë presioni të lartë i këtij kolektori, është i domosdoshëm për faktin se duke qenë një kolektor i vjetër prësa i përket ndërtimit dhe funksionimit të tij, mbeturinat e depozituara kanë shkaktuar ulje të përcjellshmërisë së ujërave të ndotura, duke punuar kështu me reth 60 % të kapacitetit tij përcjellës.

Rruga” Petraq Boshnjaku”



Bulevardi” Dyrrah”



Kolektori KULZ-4 me gjatësi $L=440$ ml i tipit me seksion semiovoidal me $D=0.30$, $D=0.32$ m që vazhdon në rrugën” Petraç Boshnjaku” si dhe përgjatë trotuarit në bulevardin ”Dyrrah”, dhe përfundon në rrugën “Adria”. Ky kolektor në të cilin shkarkojnë ujërat e ndotura objektet e banimit dhe të bizneseve, nuk është pastruar me automjet teknologjik me pompë presioni të lartë prej një periudhe të gjatë kohe, duke krijuar kështu vështirësi në funksionimin e tij dhe duke punuar me reth 60 % të kapacitetit tij përcjellës.

- ***Lagja nr.5 rruga”Mujo Ulqinaku”***

Kjo zonë që përfshin zonën nr.9 të faturimit ndodhet në pjesën veri-lindje të qytetit dhe njihet jo vetëm si zonë banimi, apo si zonë me shumë aktivitete biznesi, por edhe si zonë ku ushtrojnë aktivitetin e tyre institucione administrative dhe arsimore dhe që përfshin një hapësirë relativisht të madhe, ku jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetet e tyre një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së qytetit.

Rruga "Mujo Ulqinaku"



Në rrugën "Mujo Ulqinaku" kolektorit kryesor S-7 është ndërtuar rreth vitit 1954, është projektuar si kanal i tipit seksion rrethor, me gjatësi $L=670$ ml, i përbërë nga tubacione me diametër $\text{Ø}600$ mm betoni, duke filluar nga pallati sportit "Ramazan Njala" vazhdon me të njëjtin diametër përgjatë kësaj rruge, dhe në rrugën "Hysen Kërtusha" ndryshon diametër në $\text{Ø}1000$ b/arme, dhe shkarkon në Stacionin e Pompave të UN nr.7



Kolektori kryesor i kësaj rruge është kolektor që grumbullon ujërat e ndotura të të gjithë objekteve të banimit, të bizneseve të objekteve sportive dhe shkollave, objekte të cilat pas viteve 90-të janë shtuar për shkak të ndryshimeve demografike që ka pësuar qyteti, duke bërë që ky kolektor të shfrytëzohet mbi kapacitetin për të cilin është projektuar.

Në këtë kolektor shkarkojnë ujërat e ndotura edhe kolektorët sekondarë të projektuar me tubacione me diametër Ø200 ÷ Ø600 mm betoni që shtrihen përgjatë rrugëve sekondare, si anekse të rrugës “Mujo Ulqinaku”, të cilët mbledhin shkarkimet e ujërave të ndotura të godinave të banimit, të bizneseve të objekteve sportive, institucioneve administrative, si dhe shkollave dhe çerdheve, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë zonë. Funksionimi i kolektorëve sekondarë varet nga pastrimi, mirëmbajtja dhe mirëfunksionimi i kolektorit kryesorë.

Periudha e gjatë e mospastrimit me automjet teknologjik me pompë presioni të lartë, si dhe mungesa e herë pas herëshme e kapakëve të pusetave të kontrollit për shkak të fenomenit të vjedhjes, ka shkaktuar depozitime të mbetjeve të ndryshme, gjë e cila reflektohet dhe në vështirësinë me të cilën ky kolektor funksionon, dhe duke punuar me rreth 50 % të kapacitetit tij përcjellës.

- ***Lagja nr.11 rruga” Mustafa Varoshi”***

Kjo zonë që përfshin zonën nr.5 të faturimit ndodhet në pjesën jug-perëndimore të qytetit dhe njihet jo vetëm si zonë e vjetër banimi, por edhe si zonë ku ushtrojnë aktivitetin e tyre institucione administrative dhe arsimore- kulturore, dhe që përfshin një hapësirë relativisht të madhe të qendrës së qytetit e cila trajtohet dhe si zonë turistike, ku jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetet e tyre një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së qytetit.

Rruga” Mustafa Varoshi”



Kolektori kryesor K-9/1 me gjatësi $L=400$ m, që shtrihet përgjatë kësaj rruge është ndërtuar rreth vitit 1956 dhe është projektuar si kanal i përbërë nga dy pjesë, ku pjesa e parë e tij është projektuar si kanal me seksion vezak me $D=0.50$ m, dhe pjesa e dytë është projektuar si kanal me seksion rrethor, tubacion me diametër $\varnothing 400 \div \varnothing 500$ mm betoni, në të cilin shkarkojnë ujërat e ndotura objektet e banimit, si dhe objektet private dhe publike.

Në këtë kolektor shkarkojnë ujërat e ndotura edhe kolektorët sekondarë të projektuar me tubacione me diametër $\varnothing 200 \div \varnothing 400$ mm betoni që shtrihen përgjatë rrugëve sekondare, si anekse të rrugës “Mustafa Varoshi”, të cilët mbledhin shkarkimet e ujërave të ndotura të blloqeve të caktuara godinash banimi, publike dhe bizneseve, dhe funksionimi i kolektorëve sekondarë varet nga pastrimi, mirëmbajtja dhe mirëfunksionimi i kolektorit kryesorë.

Kolektori kryesor në këtë zonë të qytetit nuk është pastruar prej shumë vitesh me automjet teknologjik me pompë presioni të lartë, dhe depozitimi i mbetjeve të ndryshme ka sjellë vështirësinë në funksionimin e tij, duke punuar me reth 50 % të kapacitetit të tij përcjellës.

Rruga” Filonid Durrsaku”



Kolektori K-12/1 me gjatësi $L=160$ m që shtrihet përgjatë kësaj rruge është projektuar rreth vitit 1957 i tipi me seksion rrethor $\varnothing 300$ mm betoni dhe mbledh ujërat e ndotura të objekteve të banimit të një lagjeje të vjetër të qytetit dhe që përfshihet brenda zonës nr.5 të faturimit.

Mungesa e pastrimit prej vitesh e këtij kolektri me automjet teknologjik me pompë presioni të lartë, si dhe shkarkimi i tij në kolektorin kryesor të rrugës "Mustafa Varoshi", ka shkaktuar vështirësi në përcjelljen e ujërave të ndotura të banesave, duke bërë që kolektori të punoj me reth 50 % të kapacitetit tij përcjellës.

Rruga "Kumini"



Kolektori K-11/1 me gjatësi $L=180$ ml që shtrihet përgjatë kësaj rruge është projektuar rreht vitit 1957 i tipi me seksion rrethor $\varnothing 400$ mm betoni dhe mbledh ujërat e ndotura të objekteve të banimit të një lagjeje të vjetër të qytetit dhe që përfshihet brenda zonës nr.5 të faturimit.

Mungesa e pastrimit prej vitesh e këtij kolektri me automjet teknologjik me pompë presioni të lartë, si dhe shkarkimi i tij në kolektorin kryesor të rrugës "Mustafa Varoshi", ka shkaktuar vështirësi në përcjelljen e ujërave të ndotura të banesave, duke bërë që kolektori të punoj me reth 50 % të kapacitetit tij përcjellës.

- ***Lagja nr.12 rruga "Abaz Çelkupa"***

Kjo zonë që përfshin zonën nr.12 të faturimit, ndodhet në pjesën veri-lindje të qytetit dhe njihet jo vetëm si zonë banimi dhe zonë ku ushtrojnë aktivitetin e tyre institucione administrative dhe dhe arsimore, por edhe si zona më industriale, ku përfshihen jo vetëm Tregu i Frutave, Tregu Industrial, por edhe objekte të shumta biznesi, duke përfshirë një hapësirë relativisht të madhe, ku jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre një pjesë relativisht e madhe e popullsisë së qytetit.

Rruga "Abaz Çelkupa"





Kolektori kryesor S-8 në rrugën “Abaz Çelkupa” është ndërtuar rreth vitit 1967, dhe është projektuar si kanal i tipit me seksion rrethor me gajtësi $L=690$ ml, dhe i përbërë nga tubacione me diametër $\text{Ø}600 \div \text{Ø}1000$ mm b/arme, duke filluar tek qendra elektroshtëpiake “Globe” dhe shtrihet përgjatë kësaj rruge duke shkarkuar tek kolektori i rrugës “Hysen Kërtusha”.

Kolektori kryesor i kësaj rruge është kolektor që grumbullon ujërat e ndotura të të gjithë objekteve të banimit, shkollave, qendrave tregtare, bizneseve, objekte të cilat pas viteve 90-të janë shtuar për shkak të ndryshimeve demografike që ka pësuar qyteti, duke bërë që ky kolektor të shfrytëzohet mbi kapacitetin për të cilin është projektuar.

Në këtë kolektor shkarkojnë ujërat e ndotura edhe kolektorët sekondarë të projektuar me tubacione me diametër $\text{Ø}200 \div \text{Ø}500$ mm betoni që shtrihen përgjatë rrugëve sekondare, si anekse të rrugës “Abaz Çelkupa”, të cilët mbledhin shkarkimet e ujërave të ndotura të blloqeve të godinave të banimit, të objekteve institucionale dhe të bizneseve. Funkzionimi i kolektorëve sekondarë varet nga pastrimi, mirëmbajtja dhe mirëfunksionimi i kolektorëve kryesorë.

Periudha e gjatë e mos pastrimit me automjet teknologjik me pompë presioni të lartë, si dhe mungesa e herë pas herëshme e kapakëve të pusëve të kontrollit për shkak të fenomenit të vjedhjes, ka shkaktuar depozitime të mbetjeve të ndryshme, gjë e cila reflektohet dhe në vështirësinë me të cilën ky kolektor funksionon, dhe duke punuar me rreth 50 % të kapacitetit tij përcjellës.

- ***Lagja nr.17 rruga” Neki Libohova”***

Edhe kjo zone që përfshin zonën nr.10 të faturimit, ndodhet në pjesën veri-lindje të qytetit parallel me rrugën “Abaz Çelkupa” dhe njihet jo vetëm si zonë banimi, institucionale, arsimore dhe shëndetësore, por edhe si zonë industriale, ku përfshihet Tregu Industrial, si dhe objekte të shumta biznesi, dhe që përfshin një hapësirë relativisht të madhe, ku jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre një pjesë relativisht e madhe e popullsisë së qytetit.

Rruga”Neki Libohova”



Kolektori kryesor në rrugën “Neki Libohova” është zgjatim i kolektorit kryesor S-9, ku përgjatë kësaj rruge ndryshon diametër në Ø1000 b/arme deri në rrugën “Hysen Kërtusha”. Segmenti i kolektorit S-9 shtrihet përgjatë rrugës “Neki Libohova” është projektuar me diametër Ø1000 mm b/arme dhe gjatësi L= 790 ml, ku përgjatë rrugëve sekondare, si anekse të rrugës “Neki Libohova”, shtrihen kolektorët sekondarë me diametër Ø200 ÷ Ø400 mm betoni, të cilët mbledhin shkarkimet e ujërave të godinave të banimit, të objekteve institucionale dhe të bizneseve. Funkionimi i kolektorëve sekondarë varet nga pastrimi, mirëmbajtja dhe mirëfunksionimi i kolektorëve kryesorë.



Periudha e gjatë e mos pastrimit me automjet teknologjik me pompë presioni të lartë, si dhe mungesa e herë pas herëshme e kapakëve të pusëve të kontrollit për shkak të fenomenit të vjedhjes, ka shkaktuar depozitime të mbetjeve të ndryshme, gjë e cila reflektohet dhe në vështirësinë me të cilën ky kolektor funksionon, dhe duke punuar me rreth 50 % të kapacitetit tij përcjellës.

- **Rruga "Aleksandër Goga" ku përfshihen lagjet nr.6, nr.10, nr.15, nr.18**

Kolektori kryesor që shtrihet përgjatë rrugës "A.Goga" përfshin disa zonat nr.6, nr.7, nr.11, nr.12, nr.14, nr.17, nr.27, nr.29 të faturimit të cilat ndodhen në pjesën veriore të qytetit. Kjo zonë njihet si zona më e madhe industrial e qytetit, ku përveç godinave të banimit ka një numër të madh godinash institucionale, arsimore dhe shëndetësore, si dhe objekte të shumta biznesi, dhe që përfshin një hapësirë relativisht të madhe, ku jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre një pjesë relativisht e madhe e popullsisë së qytetit.

Rruga "Aleksandër Goga"



Kolektori kryesor S-12 si njëri prej kolektorëve në rrugën "Aleksandër Goga" është ndërtuar rreth vitit 1955, dhe është projektuar si kanal i tipit me seksion rrethor me gjatësi $L=1230$ ml, dhe diametër $\varnothing 600$ mm betoni, duke filluar nga supermarketi "KMY" dhe shtrihet përgjatë kësaj rruge deri pranë Spitalit Rajonal Durrës, duke shkarkuar tek kolektori i rrugës "Ahmet Ramzoti". Kolektori $\varnothing 800$ mm b/arme me gjatësi $L=350$ ml fillon pranë Spitalit Rajonal Durrës duke ndryshuar diametër në $\varnothing 600$ mm betoni.





Në gjatësi të këtij kolektor, shkarkojnë kolektorë sekondarë me diametër $\text{Ø}200 \div \text{Ø}400$ mm betoni, që shtrihen në ato rruhë si anekse të rrugës “Aleksandër Goga”, ku mbledhin shkarkimet e ujërave të godinave të banimit, të objekteve institucionale dhe të bizneseve. Funksionimi i kolektorëve sekondarë varet nga pastrimi, mirëmbajtja dhe mirëfunksionimi i kolektorëve kryesorë. Periudha e gjatë e mos pastrimit me automjet teknologjik me pompë presioni të lartë, si dhe mungesa e herë pas herëshme e kapakëve të pushtave të kontrollit për shkak të fenomenit të vjedhjes, ka shkaktuar depozitime të mbetjeve të ndryshme, gjë e cila reflektohet dhe në vështirësinë me të cilën ky kolektor funksionon, dhe duke punuar me reth 50 % të kapacitetit tij përcjellës.

Një rëndësi të veçantë për mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimeve dhe funksionimin me kapacitet të plotë përcjellës të kolektorëve kryesorë dhe sekundarë të lagjeve të qytetit, ka edhe pastrimi i puseve të stacioneve të pompimit të ujërave të ndotura, të cilat janë të shpërndarë jo vetëm në zonën e qytetit, por edhe në zonë e plazhit. Në puses e këtyre stacioneve grumbullohen jo vetëm sasi të mëdha mbeturinash të ndryshme tekstili, plastike, por kemi të pranishëm edhe prezencën e madhe të rërës që depozitohet në puset e stacioneve të zonave të plazhit.

Puset që do të pastrohen me automjet teknologjik me pompë presioni të lartë, janë puset e stacioneve të pompimit të ujërave të ndotura përkatësisht sipas formës dhe përmasave nr.1/1(3x2.5m), nr.1/2(3.2x3.0m), nr.1/3(3.3x3.0m), nr.1(Ø7.1), nr.2(Ø7.1), nr.4(Ø8.0), nr.5(Ø8.0), nr.8 e Re (5.3x5.1),zona plazh, stacionet nr.7 e Re(Ø7.9), dhe nr.8 e Re(Ø4.9),nr.9(13x6.5m), zona qytet, si dhe në zonën e Gjirit të Lalzit nr.1, nr.2, nr.3, nr.4 (Ø3.6)

II. OBJEKTIVI.

Objektivi i këtij projekti është përmirësimi i rrjetit të ujërave të ndotura për zonat e shqyrtuara më sipër nëpërmjet pastrimit të mbeturinave të ngurta (aluvione, plastikë, tekstile etj;) që gjenden të pranishme në kolektorët kryesorë të ujërave të ndotura. Matja e njësisë së punës për pastrimin e kolektorëve do bëhet në m³ sipas volumit të pastrimit në varësi të seksionit të tubacionit.

III. QËLLIMI I PROJEKTIT.


Qëllimi i objektit është rritja e kapacitetit përcjellës të tubacioneve të ujërave të ndotur rikthimi i tyre në gjendje optimale, minimizimi i fenomenit të përmytjeve si dhe rritje të cilësisë së jetës. Projekti konsiston në largimin e papastërtive me makineri autobot teknologjik me sonda presioni për lëvizjen e aluvioneve brenda në tubacion dhe më pas transportin e këtyre mbeturinave me automjete të posacme, me kazan të mbyllur për të mos ndotur ambientin.

Etapat e punës së autobotit janë të ilustruara në skemat e mëposhtme, e cila fillon me procesin e futjes së sondës së presionit në tubacionin e ujërave të ndotura, tërheqjen e aluvioneve në pusetën e kontrollit me anë të krikut hidraulik dhe më pas thithjen e tyre me autobotin e vakumit dhe transportin e tyre në vendgrumbullim të miratuar.

1. Përgatitja e procesit punes


1-1 Automjet teknologjik me pompe presioni te larte

Vendosni automjetet në anën e poshtme të kanalizimeve.




1-2 Sonada e presionit te larte.

Lidhni një hundë në një zorrë me presion të lartë.




1-3 Automjet teknologjik me pompe presioni te larte.

Pas futjes së sondes në kanalizim, vendosni një rul udhëzues.




1-4 Automjet teknologjik me pompe presioni te larte dhe autobot furnizimi me uje.

Lidhni një zorrë për furnizimin me ujë të Automjetit teknologjik me pompe presioni të lartë nga autoboti i ujit. Lidhni një zorrë tjetër në valvulën e thithjes së kamionit të depozitës së llumit, futeni në kanalizim.




1-5 Kamion me vakum



2. Operacioni punes


2-1 Automjet teknologjik me pompe presioni te larte

Rrjedha e ujit me presion të lartë e bën hundezën të shkojë përpara në kanalizim. Hundezën ka impulsione duke nxjerrë ujë me presion të lartë.




2-2 Pastrues uji

Hundeza mbështillet me mbështjellje dredha-dredha hidraulike dhe akumulimi materialit do të mblidhet nga uji me presion të lartë nga hunda.




2-3 Kamion me vakum me rezervuar llumi

Pas thithjes së llumit nga kamioni vakum me rezervuar llumi, keni dy mënyra shkarkimi.




1. Kur bëni presion në rezervuarin e marrësit, ai mund të shkarkojë ujërat e zeza përsëri në kanalizim menjëherë pa e ngritur rezervuarin e llumit.
2. Ngrini rezervuarin e llumit lart dhe kthejeni ujërat e zeza në kanalizim.




2-4 Kamion me vakum

Kur rezervuari i marrësit është plot, edhe pse kryeni operacionin e mësipërm 2-3.

Kamioni me rezervuar të llumit hedh materialin e trashë të akumuluar në vendepozitim e percaktuar.




Duke vendosur kamionë të tjerë me vakum me rezervuar llumi, do të mund të operojnë vazhdimisht pa ndërprerë procesin e pastrimit.



2-5 Kamion me vakum me krike

Kamioni me vakum me krike është në gjendje të shkarkojë ujërat e zeza me anë të sistemit të dehidrimit njëlloj si Kamioni i depozitës së llumit dhe kamioni e ngarkon materialin në kamionë të tjerë me krike si më poshtë.



IV. VOLUMET E PUNIMEVE.

Volumet kryesore të punimeve janë:

NR	Emërtimi rrugës	Diametri tubit (mm)	Gjatësia (m)	Seksioni mbushur (%)	Volumi inerteve (m3)	Numri i pusetave (copë)	Dimensioi soletës së pusetave (m)	Volumi inerteve (m3)
1	Aleksander Goga	600	1230	50	208.6	41	0.8x0.8	10.3
		800	350	40	105.5	10	1x1	2.5
2	Currila	600	1150	60	195.0	32	0.8x0.8	8.0
3	Enver Zazani	400	280	60	21.1	23	0.8x0.8	5.8
4	P.Boshnjaku+Dyrrah	300	440	60	18.7	16	0.8x0.8	4.0
5	Egnatia	1000	1460	30	343.8	22	1x1	5.5
6	Neki Libohova	1000	790	50	310.1	36	1x1	9.0
7	Abaz Celkupa	1000	690	50	270.8	38	1x1	9.5
8	Mujo Ulqinaku	600	670	50	94.7	20	0.8x0.8	5.0
9	Mustafa Varoshi	400	400	50	25.1	18	0.8x0.8	4.5
10	Kumini	400	180	50	11.3	12	0.8x0.8	3.0
11	Filonid Durrsaku	300	160	50	5.7	10	0.8x0.8	2.5
12	Spiro Puteci	500	290	50	28.5	18	0.8x0.8	4.5
13	Tubacion kunetave te shiut Ø200-250mm		2000	30	23.8			
14	Puseta te ujerave te shiut					500	0.6x0.3	45.0
15	Stacioni Pompimit 1/1					1	3.0 x 2.2	6.6
16	Stacioni Pompimit 1/2					1	3.2 x 3.0	9.6
17	Stacioni Pompimit 1/3					1	3.3 x 3.0	9.9
18	Stacioni Pompimit 1					1	Ø 7.1m	23.7

19	Stacioni Pompimit 2					1	Ø 7.1m	19.8
20	Stacioni Pompimit 3					1	2.0 x 1.8	2.9
21	Stacioni Pompimit 4					1	Ø 8 m	25.1
22	Stacioni Pompimit 5					1	Ø 8 m	25.1
23	Stacioni Pompimit 5/1					1	5.3 x 5.10	13.5
24	Stacioni Pompimit 6					1	Ø 7.6m	22.7
25	Stacioni Pompimit 7					1	Ø 7.9m	24.5
26	Stacioni Pompimit 8					1	Ø 4.9m	11.3
27	Stacioni Pompimit 9					1	Ø 3.6m	5.1
28	Stacioni Pompimit Gjiri Lalezit nr.1					1	Ø 3.6m	6.1
29	Stacioni Pompimit Gjiri Lalezit nr.2					1		3.0
Kolektor mbi 350 mm					1614.4	Puseta		119.0
Kolektor nen 300 mm					48.1	Stacion pompimi		208.9
Totali			8090	1662.6	746			327.9

V. KONKLUZIONE.

Në përfundim të projektit për zonën në studim me objekt: “PASTRIM KOLEKTORËVE TË UJËRAVE TË NDOTURA” konkludojmë si më poshtë:

Projekti do të realizohet në një faze .

Preventivat e zbatimit janë vlerësuar sipas VKM. Nr.629 date 15.07.2015 dhe studimit të tregut.

Analizat e çmimeve sipas normativave të tregut.

HARTOI

Ing. Hidro. Lorenc Facja
Ing. Hidro. Bledar Metalla

PROJEKT ZBATIMI

OBJEKTI:“PASTRIM KOLEKTORËVE KRYESORË TË UJËRAVE TË NDOTURA NË QYTETIN E DURRËSIT”

- RELACIONI TEKNIK
- PREVENTIVI I OBJEKTIT
- ANALIZE TEKNIKE E ÇMIMEVE
- FLETË PROJেকTI

PREVENTIV

OBJEKTI:“ PASTRIM KOLEKTORËVE KRYESORË TË UJËRAVE TË NDOTURA NË QYTETIN E DURRËSIT”

ANALIZA TEKNIKE

OBJEKTI:“ PASTRIM KOLEKTORËVE KRYESORË TË UJËRAVE TË NDOTURA NË QYTETIN E DURRËSIT”